

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-104/2015**

**Prishtinë,  
18 tetor 2017**

Në çështjen juridike të:

**V. M.**

**Pala ankuese**

kundër.

**A. Z.**

**Pala përgjegjëse në ankesë**

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit, Anna Bednarek dhe Shukri Sylejmani, Gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/244/2014 (lënda e regjistruar në AKP me numrat KPA10742 dhe KPA10743), të datës 18 qershor 2013, pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 18 tetor 2017, mori këtë:

## AKTGJYKIM

1. Ankesat e V. M. të regjistruara me numrat GSK-KPA-A-104/2015 dhe GSK-KPA-A-105/2015 bashkohen në një lëndë të vetme me numër GSK-KPA-A-104/2015.
2. Ankesat e paraqitura nga V.M. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/244/2014 lidhur me kërkesën e regjistruar në AKP me numrat KPA10742 dhe KPA10743, refuzohen si të pabazuara.
3. Vendimi KPCC/D/A/244/2014 sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numrat KPA10742 dhe KPA10743, vërtetohet.

### Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 23 nëntor 2006, V. M. (tani e tutje: pala ankuese) ka paraqitur dy kërkesa pranë Agjencisë Kosovare të Pronës (tani e tutje "AKP") duke kërkuar kompensim për ngastrat të cilat janë konfiskuar nga shteti: ngastra kadastrale nr. 80/1, tokë e kultivuar në sipërfaqe prej 00.85.61 ha; ngastra kadastrale nr. 82, tokë e kultivuar në sipërfaqe prej 00.48.99 ha dhe ngastra kadastrale nr. 136, tokë e kultivuar në sipërfaqe prej 00.60.47 ha; të gjitha në Komunën e Vushtrrisë (tani e tutje: pronat e kërkuara). Pala ankuese ka cekur datën: 1 qershor 1999 si datë të humbjes së posedimit mbi pronat.
2. Në mbështetje të kërkesave të tij, pala ankuese i ka dorëzuar AKP-së këto dokumente:
  - Kopjen e fletës poseduese nr. 1, të lëshuar nga Autoriteti Gjeodezik për Patundshmëri dhe Kadastër i Zonës Kadastrale së Vërnices më 21 shkurt 1997 në të cilën ngastrat kadastrale nr. 80/1 dhe 82 figurojnë të regjistruara në emër të S.M., nëna e ndjerë e palës ankuese.
  - Kopjen e certifikatës së lindjes së palës ankuese nr. 200-6315/2001-III, të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Civil në Krlevë më 30 gusht 2001.
  - Kopjen e certifikatës së vdekjes nr. 203-1-63/2001-40, të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Civil në Krlevë më 27 shtator 2001, në të cilën figuron se S.M. vic ka vdekur më 23 shtator 2001.
  - Kopjen e vendimit nr. 461-35 të lëshuar nga Komisioni për zhvillimin e procedurës dhe vendosjen lidhur me kërkesat për kthimin e tokës më 1 shkurt 1994, me ç' rast kërkesa e S. M. si pasardhëse e M. M. është pranuar si e bazuar dhe pronat e kërkuara i janë kthyer në pronësi dhe posedim të S. M. Sidoqoftë, në vendim është cekur se për shkak të faktit që kthimi i ngastrave të shpronësuara (pronat e kërkuara) nuk është i mundur, pasi që ato ishin subjekt i pronësisë së personave fizikë, Komisioni ka urdhëruar kthimin e tokës në sipërfaqe dhe klasë adekuate.
3. Njoftimi i pronës në lëndën nr. KPA10742 është bërë më 22 korrik 2010 përmes publikimit në gazetën njoftuese të AKP-së nr. 5 dhe buletinin e zyrës për pronë të UNHCR-së. Gazeta dhe lista i janë lënë kryetarit të fshatit i cili ka pranuar që t'i vë në dispozicion të palëve të interesuara. Publikimet e njëjta janë lënë në hyrjen dhe daljen e fshatit Vërnice, Komuna e Vushtrrisë, në Zyrën e Kadastrit në Vushtrri, Gjykatën Komunale të Vushtrrisë, si dhe në Zyrën Rajonale të AKP-së në Mitrovicë. Përveç kësaj, lista dhe gazeta janë shpërndarë në zyrën kryesore të UNHCR-së, Avokatit të Popullit, Agjencinë Kadastrale të Kosovës (AKK), Këshillin Danez për Refugjatë (DCR), Agjencinë Kosovare të Privatizimit, UNMIK dhe OSBE.

4. Njoftimi i pronës në lëndën nr. KPA10743 është bërë më 15 prill 2010 dhe ngastra kadastrale nr. 136 është gjetur e zënë nga A. Z. i cili ka pretenduar të drejtat pronësore mbi pronën (tani e tutje “pala përgjegjëse në ankesë”).
5. Më 2 prill 2010, pala përgjegjëse në ankesë ka paraqitur përgjigje ndaj kërkesës në të cilën pretendonte se e kishte blerë ndër të tjera ngastrën e tokës nr. 136 me kontratën e rregullt të datës 22 gusht 2000 nga N. dhe B. E. Së bashku me përgjigjen ai i ka paraqitur Sekretariatit Ekzekutiv të AKP-së dokumentet në vijim:
  - Kopjen e kontratës së shitblerjes të lidhur më 3 gusht 2000 në mes N. dhe B.E., të dy në cilësinë e shitësve, të përfaqësuar nga avokati R. M. dhe palës përgjegjëse në ankesë në cilësi të blerësit të ngastrës kadastrale nr. 136, në mesin e pronave tjera. Nënshkrimet janë vërtetuar më 22 gusht 2000 pranë Gjykatës Komunale të Mitrovicës dhe mbajnë numrin e referencës Leg. Nr. 123/2000.
  - Kopjen e fletës poseduese nr. 61, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi e Komunës së Vushtrrisë më 22 gusht 2000, në të cilën ngastra kadastrale nr. 136 figuron e regjistruar në emër të palës përgjegjëse në ankesë.
6. Sekretariati Ekzekutiv i AKP-së ka verifikuar negativisht vendimin nr. 461-35. Certifikata mbi të drejtat e paluajtshme P-7020215 e lëshuar nga Zyra Kadastrale e Komunës së Vushtrrisë më 16 tetor 2008 e cila ishte siguruar sipas detyrës zyrtare nga Sekretariati Ekzekutiv i AKP-së tregon vetëm ngastrën kadastrale nr. 80 (jo e ndarë në ngastrën kadastrale nr. 80/1 siç është pretenduar nga pala ankuese). Për më tepër, ngastra kadastrale nr. 80 është gjetur të jetë pronë shoqërore, e regjistruar në emër të Ndërmarrjes "Kooperativa Bujqësore". Ngastra kadastrale nr. 82 u gjet si pronë shoqërore e regjistruar në emër të Ndërmarrjes "Kooperativa Bujqësore". Sekretariati Ekzekutiv i AKP-së ka verifikuar pozitivisht kontratën e shitblerjes të dorëzuar nga pala përgjegjëse në ankesë, ndërsa ngastra kadastrale 136 është gjetur të jetë e regjistruar në emër të B. E.
7. Me vendimin KPCC/D/A/244/2014 e datës 18 qershor 2014, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës ka hedhur poshtë kërkesat. Në paragrafët 39 dhe 82 të vendimit grupor, të cilët sipas vendimit të certifikuar zbatohen në mënyrë specifike për rastet në fjalë, Komisioni ka vërejtur se paraqitësi i kërkesës ka kërkuar vetëm kompensimin për pronën bujqësore të humbur gjatë konfliktit të viteve 1998-1999. Sidoqoftë, sipas Rregullores UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni nuk ka juridiksion mbi kërkesat e tilla.
8. Më 7 tetor 2014, palës ankuese i është dorëzuar vendimi. Më 23 tetor 2014, ai ka paraqitur ankesë. Më 8 tetor 2014, palës përgjegjëse në ankesë i është dorëzuar vendimi. Kopja e ankesës i është dërguar palës përgjegjëse në ankesë më 23 prill 2015; sidoqoftë, ai nuk ka paraqitur përgjigje ndaj saj.

### **Pretendimet e palës ankuese**

9. Pala ankuese pretendon se vendimi i KKPK-së është bazuar në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe në zbatim të gabuar të ligjit material. Sipas mendimit të tij, Komisioni gjatë procesimit të kërkesës së tij, nuk e ka marrë parasysh fletën poseduese nr. 1 të dorëzuar nga ai, e cila dëshmon të drejtën pronësore mbi pronat e kërkuara të cilat i ka trashëguar nga nëna e tij e ndjerë S.M. Për këtë arsye, Komisioni gabimisht ka konstatuar se pronat e kërkuar janë uzurpuar në mënyrë të kundërligjshme.

10. Në fund, pala ankuese kërkon nga Gjykata Supreme që ta ndryshojë vendimin e KKPK-së dhe t'ia vërtetojë atij të drejtat pronësore.

### **Arsyetimi ligjor**

#### *Bashkimi i ankesave*

11. Sipas nenit 13.4 të Ligjit nr. 03/L-079, Gjykata Supreme mund të vendosë për ankesat e bashkuara apo të shkruara kur për bashkimin apo shkrirjen e tillë është vendosur nga Komisioni, në pajtim me nenin 11.3 (a) të ligjit. Ky nen ia lejon Komisionit që të marrë parasysh bashkimin apo shkrirjen e kërkesave me qëllim të shqyrtimit të tyre dhe marrjes së vendimeve lidhur me to kur ka çështje të përbashkëta dhe të qarta ligjore që duhet shqyrtuar.
12. Dispozitat e Ligjit për procedurën kontestimore të cilat janë të zbatueshme në procedurën para Kolegjit të Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme në përputhje me nenin 12.2 të Ligjit nr. 03/L-079, si dhe sipas dispozitave të nenit 408.1 në lidhje me nenin 193 të Ligjin nr. 03/L006 të procedurës kontestimore, sigurojnë mundësinë e bashkimit të të gjitha kërkesave me aktvendim nëse kjo do të siguronte efektivitetin dhe efikasitetin e gjykatës
13. Në tekstin e ankesave të paraqitur nga pala ankuese, Gjykata Supreme vëren se përveç numrit të ndryshëm të lëndës për të cilën është paraqitur ankesa, faktet, baza ligjore dhe çështjet e provave janë plotësisht të njëjta në të dy lëndët. Vetëm ngastrat kadastrale, subjekt i së drejtës pronësore të cilat janë përmendur në secilën kërkesë, janë të ndryshme. Ankesat bazohen në deklaratën e njëjtë sqaruese dhe në dokumentacion të njëjtë. Për më tepër, arsyetimi ligjor i KKPK-së për vendimet është i njëjtë.
14. Prandaj, ankesat e regjistruara me numrat GSK-KPA-A-104/2015 dhe GSK-KPA-A-105/2015 bashkohen në një lëndë të vetme me numër GSK-KPA-A-104/2015.

#### *Meritat e ankesës*

15. Gjykata Supreme ka shqyrtuar vendimin e kundërshtuar sipas dispozitave të nenit 194 të Ligjit mbi procedurën kontestimore nr. 03/L-006 (tani e tutje: LPK) si dhe pretendimet e palës ankuese dhe ka gjetur se ankesa është e pabazuar.
16. Sipas nenit 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në një urdhër nga Komisioni për ri posedimin e pronës nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm që “dëshmon” të drejtën pronësore ose të drejtën e shfrytëzimit të pronës private, por gjithashtu dëshmon se ai nuk është në gjendje ta ushtojë të drejtën e tillë pronësore për shkak të rrethanave të lidhura drejtpërsëdrejti me ose që rezultojnë nga konflikti i armatosur i cili ka ndodhur në Kosovë në mes të 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. Sidoqoftë, në këtë lëndë pala ankuese ka kërkuar vetëm “kompensimin” për ngastrat e shpronësuara . Për këtë arsye KKPK-ja ka hedhur poshtë kërkesat duke sqaruar se nuk kanë kompetenca lidhur me kërkesa të tilla në përputhje me Ligjin nr. 03/L-079.
17. Në ankesë, pala ankuese i referohet kërkesave si kërkesë për vërtetimin e së drejtës pronësore, e cila nuk korrespondon me përmbajtjen e kërkesave të tij të cilat i ka paraqitur në AKP, në të cilat ai në mënyrë eksplicite ka deklaruar se kërkon kompensim. Prandaj, qëndrimi i shprehur në ankesa duhet të trajtohet vetëm si argument mbrojtës. Gjykata, as në shkallën e parë dhe as në shkallën e dytë nuk mund të shqyrtojë *plus petitum*, gjykata shqyrton vetëm brenda fushëveprimit të kërkesës së parashtruar - argumente sipas nenit 2.1 të LPK-së, të zbatueshëm *mutatis mutandis* sipas nenit 12.2 të Ligjit nr. 03/L -079.

18. Për më tepër, as Komisioni e as Kolegji i Ankesave të AKP-së i Gjykatës Supreme nuk është kompetent për të vendosur lidhur me kërkesat për kompensim, pasi që Ligji nr. 03/L-079 nuk e përcakton mekanizmin për kompensim. Për këtë arsye, Gjykata Supreme konstaton se nuk është bërë asnjë shkelje e ligjit material ose vërtetim jo i plotë i fakteve.
19. Për më tepër, gjykata dëshiron të theksojë se çështja e vlefshmërisë së kontratës së shitblerjes të vitit 2000 e përmendur nga pala ankuese bie jashtë juridiksionit të KKPK-së dhe Gjykatës Supreme.
20. Rrjedhimisht, në bazë të nenit 13.3 (c) të Ligjit nr. 03/L-079 ankesat refuzohen si të pabazuara dhe vendimi i KKPK-së vërtetohet.
21. Ky aktgjykim nuk cenon të drejtën e palës ankuese që të paraqesë kërkesë pranë gjykatës kompetente.

### **Këshillë juridike**

Në pajtim me nenin 13.6 të Ligjit nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

**Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit**

**Anna Bednarek, Gjyqtare e EULEX-it**

**Shukri Sylejmani, Gjyqtar**

**Bjorn Olof Brautigam, Ushtrues Detyre i Referentit të EULEX-it**